



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 61 Prot.

Tiranë, më 23 / 01 / 2017

Lënda : Dërgohen rekomandime për Projektligjin “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”

Drejtuar : Z. Fatmir XHAFAJ
Kryetari i Komisionit
Komisioni Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit !

Në vijim të ftesës së Komisionit Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë disa rekomandime në lidhje me projektligjin “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”.

Së pari: Pasi u njohëm me përmbajtjen e projektligjit “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, në nenin 11 pika 2 propozojmë si më poshtë:

“2. Çdo i mitur duhet të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve, të përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.”

Në këtë pikë propozojmë të bëhet reference në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për format e Diskriminimit.

Fjala “ndëshkim” propozojmë të hiqet pasi vendoset një shenjë barazimi me fjalën “diskriminim”.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Kjo pikë është e paqartë, ndaj propozojmë kjo fjali të riformulohet si me poshtë:

“Çdo i mitur duhet të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit¹, për shkaqet e përmendura në piken 1 të këtij neni.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



¹ Format të cilat parashikohen në nenin 3 të Ligjit “ Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al